

RAPORTI MBI PËRFSHIRJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË PROGRAMET ELEKTORALE TË PARTIVE KRYESORE NË GARË PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË 25 PRILLIT 2021

Ky raport është hartuar në kuadrin e projektit “Zgjedhje Gjithëpërfshirëse” të financuar nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Përmbajta dhe pikëpamjet e shprehura janë të autorit.

Në raport u analizuan programet e katër subjekteve politike të prezantuara nga 5 shkurti deri në 5 Prill. Raporti u përgatit nga Msc. Evis Nasto.

This document is developed through the project “Inclusive Elections” funded by the UK government. The content gathered and views expressed are those of the author.

Tabela e përmbajtjes

Lista e Grafikëve	4
Shkurtime	5
I. Hyrje	6
1.1 Konteksti zgjedhor për Personat me Aftësi të Kufizuara.....	6
1.2 Qëllimi i raportit kërkimor dhe hartimi i pyetsorit.....	7
II. Përmbledhja ekzekutive	8
III. Metodologjia	10
3.1 Zbatimi i metodës kërkimore brenda parimeve etike	10
3.2 Karakteristikat demokratike të të intervistuarëve	11
IV. Përfshirja në partitë politike	13
4.1 Përfaqsimi i Personave me Aftësi të Kufizuara sipas statutit të partisë	13
4.2 Personat me Aftësi të Kufizuara brenda strukturave të zgjedhura partiake qendrore dhe lokale	16
V. Fushat prioritare në të ardhmen.....	18
5.1 Aksesimi në shërbime publike dhe jopublike	18
5.2 Aksesimi në arsim dhe shërbime të tjera	20
5.3 Një ministri më vete për çështjet sociale	23
VI. Tipologjia e programeve	25
6.1 Të përbashkëta dhe dallimet	25
6.2 Premtime të mbështetura në studime dhe konsultime	30
VII. Personat me Aftësi të Kufizuara në axhendën e fushatës.....	33
VIII. Konkluzione	35
9.1 Analiza e të dhënave cilësore	36
9.2 Përfundimet e raportit kërkimor	39
IX. Rekomandime.....	40
Referenca	41

Lista e Grafikëve

Figura 1.	Të dhëna demografike mbi të intervistuarit	11
Figura 2.	Krahasimi midis dy partive (PS-LSI) që kanë qeverisur së bashku në 2013-2017.....	27
Figura 3.	Krahasimi midis dy partive kryesore të mëdha të vendit (e majta e PS- e djathta e PD)	28
Figura 4.	Krahasimi mes dy partive LSI, forcë e tretë dhe NTH, forcë e re politike	29
Figura 5.	Diagrama Logjike e të Dhënave.....	35
Figura 6.	Piramida e Problemeve	38

Shkurtime

BB	Banka Botërore
RSH	Republika e Shqipërisë
KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KMCAP	Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KEMP)
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KZAZ	Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor
QV	Qendra e Votimit
PSSH	Partia Socialiste e Shqipërisë
OS	Organizata Socialiste
PDSH	Partia Demokratike e Shqipërisë
LSI	Lëvizja Socialiste për Integrim
NTH	Nisma Thurje
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
INSTAT	Instituti i Statistikave
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OPAK	Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuar
PKVPAK	Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
PISA	Programi i OSBE për vlerësimin ndërkombëtar të nxënësve
CDC	Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar

I. HYRJJE

1.1 Konteksti zgjedhor për Personat me Aftësi të Kufizuara.

E drejta e votës është një nga të drejtat themelore në një shoqëri demokratike. Me këtë nuk nënkuptohet vetëm pjesëmarrje në procesin politik, por përfshirje në shoqëri dhe mundësi për të shprehur mendimin mbi çështje që të shqetësojnë si individ dhe përfaqësues i një komuniteti. Mungesa e pjesëmarrjes në zgjedhje për shumë Personat me Aftësi të Kufizuara është ende një problem. Kjo përfshin mundësinë e përdorimit të informacionit në lidhje me zgjedhjet, që duhet të jetë i përshtatshëm, i arritshëm dhe i kuptueshëm (*p.sh. për personat me aftësi të kufizuara shqisore ose mendore*) si dhe të drejtës për të votuar pasi personave me aftësi të kufizuara mendore shpesh u është mohuar kjo e drejtë. Pavarësisht se Shqipëria ka miratuar KDPAK, dokumentin ligjor kyç për të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuara, në të cilën neni 29 i saj sanksionon të drejtën e Personave me Aftësi të Kufizuara për të votuar, sërish kjo e drejtë vazhdon të jetë e mohuar veçanërisht për ato persona me aftësi të kufizuar që e kanë të pamundur të dalin nga kushtet e shtëpisë dhe të aksesojnë QV.

Në kontekstin e pandemisë së COVID-19, në të cilat do të zhvillohen këto zgjedhje parlamentare, pengesat për të marrë pjesë në votime bëhen edhe më të mëdha për një ndër kategoritë më të rrezikuara nga infektimi.¹ Përpos nevojës për përshtatje të arsyeshme në qendrat e votimit për të mundësuar votimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, në këto zgjedhje pritet me interes edhe pilotimi i votimit elektronik në KZAZ nr.40 në njësinë 10 në Tiranë² për të parë nëse do të sjellë më shumë akses për këtë kategori. Edhe pse nuk ka një shifër të saktë të numrit të Personave me Aftësi të Kufizuara që do të votojnë në këto zgjedhje, statistikat e MSHMS tregojnë se në Gusht 2020, numëroheshin 148,544 persona të njohur zyrtarisht që kanë një aftësi të kufizuar. Prej tyre 74,350 persona janë invalidë pune, që nënkupton se janë në moshë për të votuar, por edhe për t'u zgjedhur si përfaqësues në parlament, nisur

1. "Njerëzit me AK, veçanërisht ata që kanë pamundësi për të komunikuar shenjat e sëmundjes dhe ata që nuk kuptojnë informacionin që u jepet janë ndër më të rrezikuarit për infektimin me COVID-19" – CDC, <https://cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/need-extra-precautions/people-with-disabilities.html>

2. Vendim i KQZ dt. 2.03.2021 <http://kqz.gov.al/2021/03/02/zaz-nr-40-caktohet-si-njesia-administrative-ku-do-te-zbatohet-projekti-pilot-per-votimin-dhe-numerimin-elektronik/>

nga po i njëjti dokument, KDPAK, prej nga buron dhe e drejta për të marrë pjesë si kandidat në zgjedhje. Megjithëse ligji i njeh këtë të drejtë këtij komuniteti prej mbi 74 mijë Persona me Aftësi të Kufizuara në moshë madhore, sërish ata ende nuk ia kanë dalë deri më tani të ketë përfaqësues të tyre në parlamentin e RSH. Kodi Zgjedhor, në proces reformimi thuajse të vazhdueshëm gjatë këtyre 3 dekadave, iu nënshtrua të tjera ndryshimeve të miratuara në 23 Korrik të 2020-ës me vullnetin e ligjvënësit në parlament, por në të ende nuk është parë e arsyeshme të diskutohet në lidhje me mundësinë e vendosjes së kuotave për Aftësitë e Kufizuara, të ngjashme me ato të barazisë gjinore. Kjo çështje nuk është ngritur në nivelin e ligjëratës politike në asnjë nga programet elektorale të deritanishme të partive kryesore në vend.

1.2. Qëllimi i raportit kërkimor dhe hartimi i pyetësorit.

Zgjedhjet janë një ndër proceset kryesore që kontribuojnë në qeverinë demokratike, në kushtet kur demokracia e drejtpërdrejtë, forma qeverisëse në të cilën vendimet politike merren direkt nga i gjithë populli, është e pamundur të praktikohet në shoqëritë e ditëve të sotme. Ushtrimi i vendimmarrjes së popullit përmes përfaqësuesve të tij, kalon përmes votës, dhe një proces zgjedhor nuk mund të jetë kurrësesi plotësisht demokratik, nëse nuk garanton gjithëpërfshirjen e çdo qytetari, përfshirë dhe ato me Aftësi të Kufizuara. Për këtë arsye monitorimi i një procesi zgjedhor nuk do të ishte i plotë, pa hedhur dritë edhe në këtë aspekt.

Ky raporti kërkimor ka për qëllim të skanojë aspektet e mëposhtme:

- ◆ Sa të orientuara janë programet e partive kryesore politike drejt realizimit të çështjeve që i përkasin kategorisë së Personave me Aftësi të Kufizuara?
- ◆ A janë trajtuar këto çështje si “kërkesa standarde” apo ka pasur analiza të kontekstit real të këtij komuniteti?
- ◆ A ka informacion të mjaftueshëm për të kuptuar dhe vlerësuar cilësinë e angazhimit të partisë për trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve që shqetësojnë Personat me Aftësi të Kufizuara?

Platforma e pyetjeve, të cilat iu adresuan kandidatëve dhe kandidatëve për deputet, në këto zgjedhje u hartua mbi bazën e indikatorëve të përcaktuar në metodologjinë e kërkimit. Hulumtimi nuk u fokusua vetëm tek premtimet e artikuluara në program, por edhe në shkallën e angazhimit të Personave me Aftësi të Kufizuara brenda strukturave qendrore dhe lokale të partive të marra në studim, duke marrë në konsideratë edhe vendimmarrjet dhe qëndrimet publike të partisë në zbatim të kërkesave të legjislacionit që trajton çështjet e Personave me Aftësi të Kufizuara.

II. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuara në procesin zgjedhor në RSH ka qenë gjithnjë në vëmendjen e OSHC dhe vendeve partnere që po ndihmojnë Shqipërinë në rrugën drejt një demokracie të shëndetshme. Në këtë raport kërkimor për zgjedhjet parlamentare të 25 Prillit merren në analizë statutet dhe programet e partive politike, të cilat skanohen imtësisht për të gjetur premtime dhe objektiva konkrete që kanë të bëjnë me Personat me Aftësi të Kufizuara. Në shqyrtim janë marrë programet e partive kryesore që dominojnë skenën politike shqiptare prej afro 3 dekadash PD, PS, LSI, si dhe një ndër subjektet e reja politike pjesëmarrëse në këtë garë. Ajo është Nisma Thurje, një organizatë aktive prej disa vitesh në shoqërinë civile e shndërruar në lëvizje politike, që synon të ketë në këto zgjedhje përfaqësuesit e saj në parlament. Raporti kërkimor është realizuar bazuar në metodologjinë cilësore. Ajo konsiston në:

- a) Punën kërkimore të dokumentave me natyrë ligjore dhe politike, studimeve dhe raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare;
- b) Identifikimin dhe analizimin e statutit, vendimmarrjeve dhe programeve elektorale të partive nga këndvështrimi i KDKPAK.
- c) Intervista me kandidatë dhe candidate për deputetë në zgjedhjet e 25 Prillit 2021.

Analiza nxjerr në pah një seri aspektesh që nuk përputhen me kërkesat dhe frymën që përcaktohet në KDKPAK dhe në Kodin Zgjedhor i cili njehtë drejtën e Personave me Aftësi të Kufizuara për t'u zgjedhur ose për t'u zgjedhur;³ hedh dritë edhe mbi arsyet direkte dhe të tërthorta mbi moszbatueshmërinë e legjisllacionit ekzistues, si dhe evidenton faktin se çështjet e Personave me Aftësi të Kufizuara shpeshherë nuk trajtohen më vete në programet elektorale, por konsiderohen si pjesë e programit social, ku përfshihen të gjitha kategoritë e disavantazhuara, pavarësisht dallimeve specifike nga njëra-tjetra. Në

3. Neni 3/pika 3 e Kodit Zgjedhor : "Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod"

ato aspekte të programit që janë bërë publike në media deri në fillim të javës së dytë të fushatës, rezultojnë të ketë pak hapësirë të dedikuar drejtpërdrejtë për Personat me Aftësi të Kufizuara. Kandidatët dhe kandidatet për deputetë pohuan se platforma elektorale është përqëndruar tek përmirësimi i ligjzbatimit, rritja e aksesueshmërisë me ndërhyrje në infrastrukturë, si dhe mbështetje me bursa sociale për Personat me Aftësi të Kufizuara për të vijuar arsimin e lartë dhe nxitjen e punësimit. Programeve u mungojnë objektiva të matshëm për këtë kategori sociale dhe përlogaritje të kostove për zbatimin e tyre. Edhe në rastin e vetëm kur këto kosto janë përlogaritur, rezulton të ketë një hendek financiar prej afro 50%, nga plotësimi i të cilit varet zbatimi i platformës elektorale për Personat me Aftësi të Kufizuara. Kandidatët dhe kandidatet për deputetë shfaqën kryesisht tendencën për t'iu referuar Personave me Aftësi të Kufizuara si pjesë e një kategorie të gjerë grupesh të disavantazuara. Në programet elektorale të marrë në shqyrtim u vu re mungesa e një objektivi konkret për vaksinimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. Edhe pse konsiderohet si arritje pozitive përfshirja e kandidatëve me Aftësi të Kufizuara në listat për deputetë, në disa raste dhe në pozicione fituese, sërish Personat me Aftësi të Kufizuara me gjasa rrezikon të mbetet i papërfaqësuar, pasi këto kandidatë nuk vetë-pranohen si të tillë dhe nuk identifikohen me këtë komunitet, për shkak të mentalitetit dhe perceptimin që shoqëria ka për ta.

III. METODOLOGJIA

3.1. Zbatimi i metodës kërkimore brenda parimeve etike.

Raporti kërkimor është mbështetur në metodologjinë cilësore, në të cilën janë përcaktuar indikatorët dhe burimet e vlerësimit të tyre. Për të pasur një tablo të plotë dhe të vërtetë në lidhje me situatën e Personave me Aftësi të Kufizuara, analiza u përqëndrua në 4 drejtime:

- ◆ Analizën e statutit të partisë me qëllim identifikimin e normave statutores që parashikojnë rregullat e pjesëmarrjes në proceset vendimmarrëse, duke respektuar edhe parimin e përfshirjes së Personat me Aftësi të Kufizuara në strukturat partiake si dhe identifikimin e atyre normave që përcaktojnë detyra dhe përgjegjësi në lidhje me çështjen në fjalë.
- ◆ Intervista gjysëm të strukturuar me kandidatë dhe candidate për deputetë, drejtues dhe drejtuese në aspektin politik në qarqe të ndryshme të vendit.
- ◆ Analizë të programit më të cilin partia është futur në garën elektorale për zgjedhjet parlamentare të 25 Prill-it.

Puna kërkimore eksploruese konsiston në: a) punën kërkimore të dokumentave me natyrë ligjore dhe politike, studimeve dhe raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe b) identifikimin dhe analizimin e statutit dhe programeve elektorale të partive nga këndvështrimi i KDPAK. Analiza nxjerr në pah një seri aspektesh që nuk përputhen me kërkesat dhe frymën që përcaktohet në KDPAK; hedh dritë edhe mbi arsyet direkte dhe të tërthorta mbi moszbatueshmërinë e legjislacionit ekzistues, si dhe evidenton faktin se çështjet e Personave me Aftësi të Kufizuara, shpeshherë nuk trajtohen më vete në programet elektorale, por konsiderohen si pjesë e programit social, ku përfshihen të gjitha kategoritë e disavantazhuara, pavarësisht dallimeve specifike nga njëra-tjetra.










Nisur nga fakti që jo të gjithë figurat politikat aktive në një parti kanë njohuri dhe ekspertizë në lidhje me çështjet sociale dhe veçanërisht për çështjet e Personave me Aftësi të Kufizuara, kërkuesi ka kampionuar në mënyrë probabilitare drejtuesit dhe drejtueset politike, kandidatët dhe candidateve për deputet mbështetur në një kriter thelbësor: Njohuritë dhe ekspertiza referuar çështjeve sociale. Hulumtimi është udhëhequr nga parimet dhe vlerat etike në respekt të konfidencialitetit të të intervistuarëve, një element

kyç për integritetin profesional të një raporti kërkimor, sidomos kur bëhet fjalë për tematika me një ndjeshmëri të lartë. Në respekt të ruajtjes së anonimatit, janë koduar të gjitha aspektet që e çënojnë atë. Informacioni i nevojshëm, në kuadër të studimit, është hulumtuar me përpikmëri nga ana e kërkuesit, duke mbajtur në konsideratë çështjet etike.

3.2. Karakteristikat demografike të të intervistuarëve.

Pjesëmarrësit në studim vijnë nga 4 subjekte politike përkatësisht si PS, PD, LSI dhe Nisma Thurje, një subjekt i ri politik pjesëmarrës për të parën herë në zgjedhje parlamentare. Nga të dhënat demografike të pasqyruara më poshtë, bie në sy se shumica e të intervistuarve janë vajza dhe gra, jo sepse është përcaktuar paraprakisht si kriter gjinor, por për faktin se gjatë fazës së identifikimit të politikanëve që kanë ekspertizë mbi çështjet sociale, veçanërisht mbi PAK, rezultoi se të tillë ishin më shumë drejtuese politike dhe candidate për deputete, në krahasim me kolegët e tyre, burra (6 nga 9 të intervistuar ishin vajza dhe gra).

Tabela 1. Të dhëna demografike mbi të intervistuarit.

Nr. i intervistës	Gjinia	Mosha	Arsimi / Profili
1.		36 vjeç	I lartë / Drejtësi, Shkenca Politike
2.		41 vjeç	I lartë / Drejtësi
3.		57 vjeç	I lartë / Sociologji - Filologji
4.		59 vjeç	I lartë / Ekonomi
5.		40 vjeç	I lartë / Mjekësi – Shëndeti Mendor
6.		28 vjeç	I lartë / Inxhinieri Ndërtimi
7.		48 vjeç	I lartë / Drejtësi
8.		25 vjeç	I lartë / Shkenca Politike
9.		20 vjeç	I mesëm profesional

Po ashtu vërehet se të intervistuarit për këtë raport kërkimor i përkasin kryesisht profilit studimor të drejtësisë dhe shkencave politike (4 nga 9), një prej tyre vjen nga studimet në shkencat sociale, një nga shkencat mjekësore dhe dy të tjerë kanë një edukim në lëmin e shkencave ekzate me profil në ekonomi dhe inxhinieri. Vetëm njëri nga kandidatët për deputetë është me arsim të mesëm profesional.

Të intervistuarit janë drejtues dhe drejtuese politik, njëherësh kandidatë dhe candidate për deputete në 5 qarqe të vendit, të shpërndarë nga veriu në jug. Ata kryesisht janë emëruar në zonën e tyre të vendlindjes për shkak të njohjes së problematikave specifike të qarkut, por mbi të gjitha, të bashkisë në zonën ku ato garojnë. Nga nëntë, prej tyre vetëm tre garojnë për herë të parë në këto zgjedhje, pjesa tjetër synojnë të marrin mandatin e tretë ose të katërt si ligjvënës në parlament.

IV. PËRFSHIRJA NË PARTITË POLITIKE

4.1 Përfaqësimi i Personave me Aftësi të Kufizuara sipas statutit të partisë.

Partitë politike përdorin zakonisht një preambulë, ose një seksion të ngjashëm, në të cilin evidentojnë parimet themelore dhe objektivat parësore që udhëheqin veprimtarinë e tyre. Formulimi zakonisht është i përgjithshëm, në mënyrë që ato të kenë një rëndësi të gjithëkohshme, por njëherësh duhet të shpërfaqin edhe aspekte të veçanta, në mënyrë që njëra parti të dallojë nga tjetra.

Në preambulën e statutit të Partisë Socialiste të Shqipërisë i amenduar së fundmi në 29 Shkurt 2020, nënvizohen *“parimet e lirisë, drejtësisë sociale, barazisë së shanseve dhe solidaritetit njerëzor; në respektimin e të drejtave të të gjithë qytetarëve dhe kujdesin që çdonjëri të përmbushë detyrat; në mbrojtjen e pluralizmit; në promovimin e mundësive të barabarta për gratë, vajzat dhe rininë; në forcimin e shtetit të së drejtës, respektimin e Kushtetutës, akteve ndërkombëtare dhe ligjeve të tjera të Republikës së Shqipërisë.”*⁴

Në statutin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, të përditësuar dhe miratuar në 28 prill 2018, parimet gjenden në seksionin e “Dispozitave të përgjithshme” ku renditen vlerat themelore politike, të cilat ashtu si në rastin e statutit të PS reflektojnë një kombinim prioritetesh për vendin, por duke ruajtur qasjen e të qenurit pjesë e familjes ideologjike të Partive Popullore Evropiane. Kjo vërehet veçanërisht në nënvizimin e vlerave si *“respektimi dhe mbrojtja e lirisë e demokracisë, ndërtimin e shtetit të së drejtës që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dinjitetin dhe personalitetin njerëzor...”* duke dalluar si parti e spektrit të djathtë në një vend post-komunist veçanërisht në përmendjen e vlerave si *“mbrojtja e familjes tradicionale në shoqëri, shenjtërimin e pronës private dhe dekomunistizimin...”*⁵

Ndryshe shpalosen parimet e subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim. Në statutin e të cilit, të rishikuar për herë të fundit në Tetor të 2012-ës, renditen në mënyrë konçize vetëm 5 parime kryesore që lidhen ngushtësisht me jetën politike brenda partisë, sikurse

4. Deklarata e Parimeve / Preambul – Statuti i Partisë Socialiste

5. Neni 1/pika 2 dhe Neni 3 “Qëllimet Politike”/pika 2 – Statuti i Partisë Demokratike

“anëtarësimi vullnetar në LSI, garantimi i të drejtave dhe lirive të shprehjes për çdo anëtar, në respekt të demokracisë së brendshme të partisë, kolegjaliteti dhe transparenca në vendimmarrje dhe votimi i fshehtë në bazë të parimit një anëtar – një votë”.⁶

Në një qasje krahasimore të statuteve të sipërpërmendura me modelet e statuteve të partive politike në sistemin e demokracive perëndimore dhe në vendet e tjera pjesë të Commonwealth-it, vërehet se nuk mungon përmendja e “personave me aftësi ndryshe/të kufizuara” duke garantuar në këtë mënyrë përfshirjen të drejtpërdrejtë edhe të kësaj kategorie në strukturat e partisë. Konkretisht në statutin e Partisë Australiane Laburiste, në Nenin 3/pika P tek kapitulli i “Objektivave” nënvizohet lufta nda diskriminimit mes shumë kategorive edhe atë të personave me aftësi të kufizuara.⁷ Diçka që nuk përmendet në statutin e Partisë Demokratike dhe as në atë të Lëvizjes Socialiste për Integrim. Ndërsa në statutin e Partisë Socialiste “aftësia ndryshe” ndeshet e përmendur vetëm një here në kapitullin e “Anëtarësisë dhe Rregullave të Anëtarësimit”, ku përcaktohet se “anëtar i Partisë Socialiste mund të jetë çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë pa dallim race, gjinie, gjuhe, etnie, arsimiti, besimi fetar, gjendjeje ekonomike, pozite shoqërore, aftësie ndryshe, që jeton brenda ose jashtë vendit.”⁸ Mospërmendja e Personave me Aftësi të Kufizuara në vlerat dhe partimet që udhëheqin PD, LSI dhe NTH nuk përbëjnë sipas kandidatëve dhe kandidateve për deputetë, pengesa reale për përfshirjen e kësaj kategorie, përkundrazi ato kanë një këndvështrim tjetër në lidhje me këtë aspekt që reflektohet në përgjigjet si më poshtë:

- ◆ “Statuti nuk është se ka përmendur diçka specifike për Personat me Aftësi të Kufizuara, por kjo është lënë të përfshihet në program. Sikurse mund të ngrihet pretendimi për përmendjen e Personave me Aftësi të Kufizuara mund të ngrihet i njëjti pretendim edhe për kategori të tjera” (Pjesëmarrësja 5, kandidate për deputete e PD).
- ◆ “Duke qene se LSI është parti integrimi, në statut nuk është vënë qëllimisht kategoria e Personave me Aftësi të Kufizuara, jo për t’u përjashtuar por ... në gjithëpërfshirje në qoftë se ne do t’a shënonim që kjo parti pranon dhe këtë dhe atë, do të kishte jo konotacionin pozitiv...shpesh herë kur thuhet këto terma duket sikur në vend që t’i integrojmë duket sikur i veçojmë dhe prandaj është zgjedhur të mos përmenden” (Pjesëmarrëse 3 kandidatja për deputete e LSI)

6. Parimet Kryesore, pika 6.1. – Statuti i Lëvizjes Socialiste për Integrim

7. (p) elimination of discrimination and exploitation on the grounds of class, race, sex, sexuality, religion, political affiliation, national origin, citizenship, age, disability, regional location, economic or household status; “A Compilation of Political Party Statutes”, NDI

8. Neni 15/pika 2 – Statuti i Partisë Socialiste të Shqipërisë

- ◆ “Statutet e partive kryesore vendosin shtyllat kryesore, parimet kryesore të një shoqërie demokratike, që nëse nesër do të jenë në qeverisje, ata të kenë si fokus kryesor, po themi parimet e përgjithshme në një vend demokratik. Në statutin e Partisë Demokratike, nuk ka detaje të zërthyer sepse duke qenë se ato ndryshojnë në vite dhe dekada të ndryshme dhe për rrjedhojë nuk mund të kesh në statut aksesueshmërinë për PAK dhe ta lësh aty në statut nga viti 1990 e deri më sot” (Pjesëmarrësja 7, kandidatja për deputete e PD).

Për NTH, Personat me Aftësi të Kufizuara konsiderohen jo si një kategori më vete, por si pjesë e një shtrese në nevojë. Në këtë mënyrë evidentohet edhe në statutin e tyre, të shpalosur në formën e një manifesti me shtyllat ideologjike ku mbështetet ky subjekt i ri politik:

- ◆ “Është tek Karta 2020, e cila përfaqëson shtyllat ideologjike aty thuhet që duhet stimuluar krijimi i skemave sociale që garanton se shtresat në nevojë përfitojnë nga përdorimi ekonomik i hapësirës publike të qyteteve. Tek kjo pikë nënkuptohen edhe personat me aftësi të kufizuara, si shtresë në nevojë.” (Pjesëmarrësi 1, kandidati për deputet i NTH)

Mospërmendja, si mënyrë për të mos i veçuar Personat me Aftësi të Kufizuara, sikurse artikulojnë më sipër përfaqësuesit politik të PD dhe LSI si dhe përmendja e tërthortë duke i identifikuar thjesht si “shtresë në nevojë” sikurse në rastin e Nismës Thurje, përbëjnë mungesa të dukshme në statutet e partive politike, të cilat nuk kanë gjetur një vend të dedikuar për Personat me Aftësi të Kufizuara në manifestin e tyre politik, njësoj sikurse kanë vepruar për kategoritë e tjera të disavantazuara. Duke bërë një paralelizëm me çështjet e barazisë gjinore të përmendura në statutet e partive, një nga kandidatet për deputet e PS sjell në vëmendje rëndësinë që ka përmendja e Personave me Aftësi të Kufizuara në statut:

- ◆ “Edhe pse dukeshë sikur do ta marginalizonte më shumë gruan, në fakt ajo që ka ndodhur, është që duke u futur kuota po fuqizohet më shumë roli i gruas. Shoqëria nuk e pranon dot ndryshe gruan përpos atij modeli me të cilin është mësuar. Edhe për aftësinë ndryshe, duhet forcuar besimin se njerëzit me aftësi ndryshe janë të zotë të prodhojnë ide dhe modele të realizuara. Ky promovimi, përmendja në statut, i bën më mirë.” (Pjesëmarrësja 4, kandidate për deputete e PS)

Edhe pse ky është vetëm qëndrimi personal i një kandidateje dhe jo propozim i një force politike në garë për zgjedhjet e 25 Prillit, sërish vendosja e kuotave për Personat me Aftësi të Kufizuara është një model i përqafuar edhe në shumë vende të BE.

Shtatë vende anëtarë, referuar të burimeve zyrtare institucionale, konfirmojnë se ekziston së paku 1 anëtar i parlamentit që është identifikuar publikisht se ka një aftësi të kufizuar. Në krye të këtyre 7 vendeve renditet Kroacia e cila ka të identifikuar 7 deputetë me aftësi të kufizuar.⁹

4.2 Personat me Aftësi të Kufizuara brenda strukturave të zgjedhura partiake qendrore dhe lokale.

Aktivizimi në një parti politike në Shqipëri udhëhiqet kryesisht për interesa ose përfitime personale (55.5%) dhe për të mbështetur familjen dhe miqtë (71.9%).¹⁰ Nga kjo qasje e matur në një studim të IDM nuk përjashtohen as Personat me Aftësi të Kufizuara. Kandidatja për deputete e PS në qarkun Tiranë, teksa pohon anëtarësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara në strukturat lokale të një prej OS-ve të degës socialiste në kryeqytet, saktëson se *“arsyeja pse janë të angazhuar është edhe për të pasur një lloj mbështetje, se të gjithë njerëzit pavarësisht se mund të kenë ato idealet të majtë, të djathtë, është më shumë për interesin vetja dhe ata luftojnë për këtë gjë”*. Mbështetja që kanë prodhuar, angazhimi politik i Personave me Aftësi të Kufizuara, rezulton nga ky hulumtim se ka qenë në nivel rastesh individuale dhe jo për komunitetin e Personave me Aftësi të Kufizuara në tërësi.

- ◆ “kryetarin e organizatës e kemi ndihmuar të punësohej në postë, punon aktualisht, ka qenë gjithë jetën pa punë” (Pjesëmarrëse 2, kandidatja për deputete e PS).
- ◆ “...për shembull në strukturat e partisë, një djemtë ka qenë me aftësi ndryshe, madje kemi bërë dhe një fushatë, që iu dedikua atëherë me qëllim për ta ndihmuar të bënte një ndërhyrje kirurgjikale. Falë angazhimit vullnetar të secilit prej nesh e arritëm ta realizonim këtë gjë.” (Pjesëmarrësja 3, kandidate për deputete e LSI)
- ◆ “Unë përpiqem të interesohem drejtpërdrejtë, t’i ezauroj të gjitha kontaktet e mia brenda ligjeve dhe normave kur ka një mundësi për t’u rikuperuar situatën në moment pasi ne kemi mundësi t’i rregullojmë gjërat dhe në pozicionet që ne mbajmë aktualisht. Unë kam qenë deputete dhe kuptohet që jam interesuar në institucionet e caktuara për raste që vijnë nga komunitete që e kanë të pamundur të interesohen.” (Pjesëmarrëse 6, kandidatja për deputete e LSI).

9. European Union Agency for Fundamental Rights – Are people with disabilities elected to national parliament?

10. Analizë e angazhimit politik në Shqipëri, IDM, 2016 - <https://ndi.org/sites/default/files/IDM%20Audit%20of%20Political%20Engagement%20%28Shqip%29.pdf>

Aktivizmi në parti nuk nënkupton gjithnjë përfaqësimin e tyre në nivele drejtuese. Me përjashtim të një prej deputeteve të PS që identifikoi një rast që i përket Personave me Aftësi të Kufizuara i zgjedhur në pozicionin e kryetarit të një prej OS-ve, njësia bazë e organizimit të këtij PS dhe forca tjetër politike, LSI, kandidatja për deputete e të cilës pohoi se në qarkun e saj *“ka përfaqësues të komunitetit të Personave me Aftësi të Kufizuara si drejtues të strukturave zonale”*,¹¹ diçka e tillë nuk u arrit të identifikohet në dijeninë e pjesëmarrësve në këtë studim nga rradhët e Partisë Demokratike.

- ◆ “Drejtues që janë nga Personat me Aftësi të Kufizuara në informacionin tim, nuk ka, por mesa di unë, ka persona që janë të përfshirë ose që janë të angazhuar në strukturat e partive. Gjithashtu ekzistojnë në çdo qark, në çdo degë të Partisë Demokratike, struktura të çështjeve sociale dhe specifiku strukturat që merren me Aftësitë e Kufizuara. Ata e kanë gjithë hapësirën që të futen në PD, të aktivizohen dhe të trajtohen si të barabartë. Nuk ka patur asnjëherë probleme me përfshirjen e tyre.” (Pjesëmarrësja 5, kandidatja për deputete e PD)

Megjithëse angazhimi politik shkon përtej angazhimit partiak sikurse shkruan studiuesja e Shkencave Politike Krahasuese, Pippa Norris, duke nënvizuar se ky koncept përfshin informimin, pjesëmarrjen politike dhe besimin politik. Në rastin e Personave me Aftësi të Kufizuara, duket se mungon interesimi për çështjet ligjore dhe nismat që prekin drejtpërdrejtë ata. Në këtë arsyetim nuk përfshihen shoqatat që kujdesen për të drejtat e kësaj kategorie, por qytetarët e thjeshtë me Aftësi të Kufizuara që në përditshmëri shpeshherë humbasin të drejtën e shërbimit edhe për mungesë njohurish. Këtë pohim e kanë bërë dy nga kandidatet për deputete si më poshtë:

- ◆ “Unë do të thoja që mungesa e edukimit dhe informimit është ajo që ndikon ndonjë herë shumë në të gjitha rastet diskriminuese apo në mungesën e aksesimit në shërbime të përditshme.” (Pjesëmarrësja 6 kandidatja për deputete e LSI)
- ◆ “...Personat me Aftësi të Kufizuar, kanë problem me këto kriteret ligjore se nuk orientohen dot, d.m.th., nuk kanë shumë qartësi të procedurave për këto pensionet e invaliditetit, po jo invaliditetit të punës por të invaliditetit të personave me aftësi ndryshe, ata që e kanë të lindur (KEMP). Kam gati 2-3 kërkesa në muaj që më duhet t’i ndjek dhe kur shkoj që i shoh kush është halli, shikoj që janë të painformuar, dmth kanë nevojë që dikush t’i mësoj.” (Pjesëmarrësja 2 kandidatja për deputete e PS).

11. Norris, P. (2000). *A Virtuous Circle: Political Communications in Post-Industrial Societies*. New York: Cambridge University Press

V. FUSHAT PRIORITARE NË TË ARDHMEN

5.1 Aksesi në shërbimet publike dhe jopublike.

Që prej vitit 2008, Këshilli i Ministrave ka miratuar një vendim “Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e Personave me Aftësi të Kufizuara”, i cili parashikon standardet e aksesueshmërisë dhe normat që duhet të zbatohen në industrinë e ndërtimit (veçanërisht në lidhje me aksesin nëpër ndërtesa, rrugë dhe mjedise të tjera të brendshme dhe të jashtme). “Nëse nuk është e aksesueshme për këtë kategori”, sikurse bën me dije kandidatja për deputete e PS, “nuk e fiton më lejen e ndërtimit.” Ndryshe nga sa thotë ligji i cituar nga kandidatja, probleme me zbatimin ndeshen ende në ditët e sotme, 13 vite pas miratimit të tij, jo vetëm në sektorin privat, por edhe në ndërtesat e institucioneve publike. Vetë objektet në varësi të MSHMS-së, institucioni bazë për shërbimet e Personave me Aftësi të Kufizuara, sikurse përcaktohet në PKVPAK, rezulton se ka akses të kufizuar. Konkreisht nga 400 objekte të kontrolluara, 34% ofrojnë akses për personat me aftësi të kufizuara, por jo të gjitha në përputhje me standardet. Një nga kandidatët për deputetë të intervistuar tregon përvojën e tij në qytetin ku jeton dhe i duhet të marrë shërbime si Persona me Aftësi të Kufizuara:

- ◆ “Bashkia e re në qytetin tim është restauruar tani, ka 3-4 muaj dhe nuk janë bërë përshtatjet për aksesin e personave me aftësi të kufizuar, edhe pse e kam çuar si problematikë shumë herë pranë bashkisë, unë dhe shumë të tjerë”. (Pjesëmarrës 9 kandidati për deputet i NTH)

Aksesi në institucione konsiderohet nga ky komunitet si A-ja prej nga duhet të nis puna për të pasur një jetesë më dinjitoze në Shqipëri. Asnjë mundësi punësimi, edukimi apo kujdesi shëndetësor, pa harruar dhe jetën sociale nuk mund të shfrytëzohet, nëse mungon infrastruktura dhe transporti publik i aksesueshëm nga Personat me Aftësi të Kufizuara. Mungesa e aksesit përbën një kosto shumë të madhe, jo vetëm personale pasi lidhet drejtpërdrejtë me humbjen e pavarësisë, por edhe një kosto për shtetin, duke qenë se shton varësinë e Personave me Aftësi të Kufizuara ndaj familjarëve që paguhen nga buxheti i shtetit për mospunësimin, me qëllim që t'i shërbejnë Personave me Aftësi të Kufizuara, si kujdestar të tyre. Të tilla barriera evidentohen edhe nga vetë kandidatët për deputet:

- ◆ “Kur unë të kem një problematikë, mami ose babi nuk do të jenë gjithnjë krah meje. Babi është në punë. Mami është pensioniste, është në shtëpi... Dhe unë dua që kur të shkoj tek bashkia, vetë si person. Në këtë moment, unë nuk mund të shkoj sepse nuk kam si të ngjisë shkallët. (Pjesëmarrës 9, kandidati për deputet i NTH).
- ◆ “Në qarkun tim pothuajse është niveli zero i trajtimit të Personave me Aftësi të Kufizuar. Fëmijët vijnë me furgona nga njësi administrative që janë goxha larg dhe kanë udhëtimin e përditshëm sepse nuk mundet të flenë në atë qendër në Burrel. Prindërit i sjellin që në mëngjes me furgon, dhe më pas janë drejtuesit e qendrës që i presin për t'i trajtuar në këtë qendër. Në këto raste ka kosto dyfish sepse duhet t'i shoqërojë dikush... Transporti dhe shoqërimi, sidomos për fëmijët që vijnë nga fshatra që janë 2 orë larg...” (Pjesëmarrësja 7, kandidatja për deputete e PD)

Megjithëse problemet me aksesueshmërinë pranohen njëzëri nga përfaqësuesit e subjekteve politike, sërish vërehet mungesa e strategjive konkrete dedikuar rritjes së lëvizshmërisë së Personave me Aftësi të Kufizuara dhe aksesit përmes ndërhyrjes në infrastrukturë dhe në transport. Të pyetur nëse kanë një plan konkret në programin e tyre për këtë kërkesë thelbësore të këtij komuniteti, kandidatët dhe kandidatet për deputetë që iu përgjigjën pyetjes, përcollën një qëndrim politikisht korrekt të natyrës konstatuese, por fare pak konkretësi në mënyrën sesi do të realizohet zbatimi më i mirë i ligjit aktual, duke dëshmuar indirekt, se aksesueshmëria mund të mbetet një shqetësim i pazgjidhur.

- ◆ “Është e rëndë të mendosh që në 62% të zyrave të punës ku ky target grup drejtohet për të kërkuar punë, nuk ke aksesueshmërinë për të hyrë fizikisht në këto zyra. Apo në shkollë, ka shumë objekte arsimore që u mungon aksesueshmëria. Në programin tonë janë detajuar konkretisht këto mungesa sa i takon aksesit të Personave me Aftësi të Kufizuara, për të qenë pikërisht seriozë me çka duam të arrijmë. Ne do të tentojmë që aty ku mungon infrastruktura që kufizon këtë target grup, të ndërhyjmë dhe të marrim masa.” (Pjesëmarrësja 7, kandidatja për deputete e PD)
- ◆ “Do të ketë organizma të posaçëm që do të merren me këta persona, ku do të ketë dhe përfaqësues të tyre, të cilët do të shqyrtojnë problematikat që ato përballen çdo ditë, duke përfshirë dhe aksesin. Gjëja më minimale që duhet bërë është që problematikat e tyre të dëgjohen dhe të zgjidhen brenda mundësive.” (Pjesëmarrësja 5, kandidate për deputete e PD)

5.2 Aksesi në arsim dhe shërbime të tjera.

Rritja e numrit të mësuesve ndihmës gjatë harkut kohor 2016-2020 është një nga treguesit që PS përmend më shpesh kur kërkon të evidentojë arritjet e saj sa i takon reformave të ndërmarra për këtë çështje gjatë këtyre 8 viteve. “Vazhdimi i konsolidimit të mësimdhënies me kushtet e personalizuara për çdo nxënës” artikullohet edhe në planin e veprimit të PS-së, në kuadër të vijimit të punës për të çuar përpara objektivat e vendosura tashmë në programin qeverisës të 2017-ës. Në ndihmë i vijnë edhe shifrat e raportuara në PKVPAK, në të cilin njihet përmirësimi i arritur në sistemin parauniversitar me afro 1236 mësues ndihmës për vitin shkollor 2019-2020, nga të cilët 86.5% u punësuan në sistemin publik. Kjo ka ndikuar në përmirësimin e raportit mësues ndihmës për fëmijë me aftësi të kufizuara. Pavarësisht nga kjo, Opozita e Bashkuar (PD – LSI) pohon në intervistat e realizuara për raportin kërkimor, se arsimit në programin e të dy forcave aleate do t’i nënshtrohet një reforme të thellë që do të përfshijë të gjithë sistemin, që nga ai parauniversitar deri tek ai i arsimit të lartë, duke renditur si prioritet plotësimin e nevojave të Personave me Aftësi të Kufizuara, mes tyre edhe ajo për mësues ndihmës, por pa dhënë objektiva specifike të matshëm mbi pritshmëritë që do të përmbushë kjo reformë.

- ◆ “Zhvillimi i një reforme të thellë në fushën e edukimit dhe arsimit me qëllim përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në sistemin publik arsimor, që të jetë i barabartë dhe i detyrueshëm me nxënësit e tjerë. Kjo është një pikat e rëndësishme dhe marrja e masave ligjore dhe administrative për zbatimin e normave ligjore për arsimin e Personave me Aftësi të Kufizuara parashikuar në ligjin e arsimit parauniversitar 2012-të. Në këto 8 vite ka pasur një rënie të PAK që vijojnë studimet e larta, pothuajse është minimizuar në limit, madje ata thonë gati është zeruar mundësia që njerëzit që vijnë nga kjo shtresë sociale të marrin bursa për të vazhduar studimet në universitet. Një pikë tjetër është të mbështes dhe të bashkëpunojë në zhvillimin e një reforme të thellë në fushën e formimit profesional dhe nxitjen për punësim për Personave me Aftësi të Kufizuara” (Pjesëmarrësja 5, kandidatet për deputete e PD)
- ◆ “Krijimi i të gjitha kushteve për infrastrukturë për Personat me Aftësi të Kufizuara për aksesin në mësimdhënie, jo vetëm online, por edhe përshtatjes së godinave arsimore sipas nevojave të rampave e kështu me radhë...jo vetëm në lidhje me infrastrukturën por mbi të gjitha dhe mësuesit ndihmës i specializuar për fushat përkatëse sepse komuniteti është i madh por nevojave të tyre specifike mund të jenë të ndryshme nga njëra tjetra. Gjithashtu trajtimi i tyre me bursa sidomos për arsimin e lartë ...” (Pjesëmarrësja 6, kandidatja për deputete e LSI)

- ◆ “Rishikimi i ligjit të arsimit parauniversitar me qëllim krijimin e një rjetëzimi të shërbimeve të kësaj kategorie...Neve në program e kemi shtimin e të gjithë shërbimeve të dedikuara që lidhet me mësuesit ndihmës, me pozicionin psikosocial dhe me shërbimet mjeksore prej dentistrisë e deri tek gjitha të tjerat. Në programin e arsimit kemi linja të dedikuara për këtë kategori, e cila do të na krijojë dhe mundësinë e një nisme tjetër, që e kemi quajtur “Ferma Pedagogjike”. Këto “ferma” do të fillojnë që në sistemin e kopshteve, ku fëmijët e vegjël nga 0 deri në 3 vjeç apo 3 deri në 6 vjeç, do të shoqërohen nga mamatë e tyre, kujdestaret apo mësueset ndihmëse, të cilat do të shtohen në programin aktual që kemi sidomos për këtë kategori”.(Pjesëmarrësja 3, kandidatja e LSI)

Modeli i socializimit të Personave me Aftësi të Kufizuara brenda të ashtuquajturave”Ferma Pedagogjike” nuk përmendet konkretisht në broshurën e programit elektoral të LSI dhe nuk është bërë publike në takimet e transmetuara në media të kandidatëve dhe kandidateve për deputet deri në fillim të javës së dytës të fushatës. Megjithatë vlen për t’u sjellë në vëmendje se ky model është realizuar si një iniciativë private në Vlorë e financuar si Start-UP nga programet e mbështetjes gjermane, GIZ.¹² Duke iu referuar asaj çka është bërë publike deri më tani, rezulton se për arsimimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, përpos aksesit në godinat arsimore, nuk ka një zë të dedikuar në programin ligjvënës të Nismës Thurje. Por kjo parti sugjeron aplikimin e një sistemi pikëzimi kur bëhet fjalë për të rritur aksesin në shërbime duke përfshirë dhe mundësinë e punësimit për njerëzit e këtij komuniteti, përmes shfrytëzimit të hapësirave publike të qytetit. Një nga kandidatët për deputet i NTH shpjegon më tej idenë e kombinimit të nevojës me mundësinë, përmes pikëve.

- ◆ “Do përpiqemi që ta bëjmë sa më objektiv shpërndarjen e shërbimeve. Nëse marrim rastin e strehimit. Ti ke 1000 kërkesa. Nga këto 1000 kërkesa, do të duhet të evidentosh kush janë më prioritare. Pra do të duhet të vendosësh kriteret. Renditja bëhet në bazë të pikëve. Letë themi: Je person me aftësi të kufizuara 10 pikë, je i ve/e ve, je me ndihmë ekonomike, je jetim. Pra aty ku është më e madhe nevoja por edhe vështirësia për ta bërë vetë. Nëse dikush nuk ka asnjë lloj disavantazhi atëherë psh në rastin e kioskave në kryeqytet, dikush mund t’i marrë vetë një hapsirë me qera nuk ka pse përfiton nga lehtësirat që ofron bashkia për të përdorur hapsirat publike për biznes...është marrë si shembull nga Greqia ku i jepet përparësi Personave me Aftësi të Kufizuara që t’i marrin kioskat dhe të bëjnë biznes.”

12. <https://adriapol.al/wp-content/uploads/2020/09/STARTUP-ET-N%C3%8B-PREZANTIMIN-FINAL-agro-challenge.pdf>

Aplikimi i një sistemi me pikë sugjerohet edhe nga LSI, por me fokus konkret në nxitjen e sipërmarrjes për të punësuar më shumë persona nga kategori të disavantazuara, mes tyre edhe Personat me Aftësi të Kufizuara. Kandidatja për deputete e kësaj force politike, tregon se në programin e LSI për rritjen e punësimit të rinjve nga mosha 18-29 vjeç, parashikohet një skemë subvencionimi që mesatarisht përlogarit të jetë në vlerën e 2000 eurove në vit, por edhe më shumë, 2300-2500 euro, në varësi të disavantazheve të rastit.

- ◆ Ka një pikëzim për këto çështje. Këto subvencionime shërbejnë që biznesi të hapi derën për të pritur dhe për të punësuar të gjithë këtë komunitet të madh sepse po flasim nga mosha e punës deri në moshën 29 vjeçare, ku për të stimuluar punësimin dhe zhvillimin ekonomik për komunitete të caktuara, për zona të caktuara të vendit ku papunësia spikat më shumë ky shkallëzim me pikë vjen më i lartë.” (Pjesëmarrësja 6, candidate për deputete e LSI)

Pikët janë një sistem që përdoren aktualisht për vlerësimin që i bëhet Personave me Aftësi të Kufizuara si përfitues të KEMP-it. Baza e reformimit të KEMP-it, e realizuar me asistencën e Bankës Botërore dhe CDC për të shmangur rastet abuzive ka qenë pikërisht “hartimi i një sistemi pikëzimi që tregon që aftësia e humbur nuk është e kthyeshme, por e përhershme. Në këtë rast mbështetja sociale vazhdon pa ndërprerje. Në qoftë se situata e individit është e rikuperueshme, atëherë individit rivlerësohet përmes analizave sa i takon statusit që ka.” (Pjesëmarrësja e 4, candidate për deputete e PS).

Sa i takon punësimit të tyre, Partia Socialiste kujton se pjesa më e madhe e kuadrit ligjor, në masën 80%, është miratuar tashmë për këtë kategori. *“Tani duhet të vazhdohen të buxhetohen se duhen buxhetuar siç duhet, duhen ngrit kapacitetet...”* – tregon pjesëmarrësja nr. 2, candidate për deputete. Ajo rendit më tej një seri ndryshimesh ligjore që janë ndërmarrë pikërisht për të favorizuar Personat me Aftësi të Kufizuara.

- ◆ “Tek strehimi social janë përfshirë si kategori të posaçme. Tek punësimi është bërë ligji me specifika të veçanta për të nxitur punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara duke krijuar lehtësi për bizneset si dhe më shumë aftësim profesional. Në ligjin e fundit, atë për prokurimin publik përcaktohet se mund të marrin pjesë në tendera edhe ato shoqëri që me kushte preferenciale, kanë të punësuar persona me aftësi ndryshe. Pra mund të themi se 80% e shqetësimeve të këtij komuniteti janë adresuar”

Nëse për PS, fokusi i punës në 4 vitet e ardhshme përqëndrohet kryesisht tek përmirësimi i zbatueshmërisë së ligjeve të miratuar tashmë, PD, LSI dhe NTH duke qenë në opozitë, janë përqëndruar në programet e tyre, tek ofrimi i alternativave të reja

për më shumë akses në arsim dhe punësim, por duke i trajtuar në tërësi kategoritë e disavantazhuara, ku përfshihen pakicat etnike, gratë e ve kryefamiljare, jetimët, invalidët, Persona me Aftësi të Kufizuara, njerëz me ndihmë ekonomike, të mbijetuara të dhunës, viktimat e trafikimit, etj.

5.3 Një ministri më vete për çështjet sociale.

Çështjet Sociale i janë bashkangjitur Ministrisë së Shëndetësisë me organizimin e ri të kabinetit qeverisës të dalë nga zgjedhjet parlamentare të 2017-ës. Vendimi u mor, sikurse shpjegojnë përfaqësuesit politik të PS, me qëllim për të unifikuar shërbimet që ndjekin njeriun nga lindja deri në vdekje. Në bilancin 4-vjeçar të shërbimeve sociale si pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë, të gjitha palët e intervistuar, duke përfshirë edhe vetë kandidatet për deputet të PS, kanë rezervat e tyre sa i takon punës së bërë dhe sugjerojnë që veçanërisht në kushtet e pandemisë, të mendohet një riorganizim më vete i çështjeve sociale brenda ekzekutivit. Teksa NTH duke pasur një program ligjvënës dhe jo qeverisës, nuk ka një qasje për këtë çështje.

- ◆ “Ky organizim është dramë, nuk ka ku të shkojë më keq, prandaj Shqipëria ka arritur në depresionin social...duhet një ministri e dedikuar për çështjet sociale që lidhet me të gjithë qasjen e mënyrës së menaxhimit të jetës së qytetarit qëkur lind e derisa vdes. Prandaj unë e shikoj pjesë të domosdoshme që qeveria që do të drejtojë vendin për 4 vitet e ardhshme të riorganizojë të të gjithë institucioneve ministrove” (Pjesëmarrësja 3, kandidatja e LSI)
- ◆ Askush nuk e mendoj që do vinte pandemia tani me këtë le të themi rrotullim të ri të botës edhe të kushteve që jemi unë mendoj që është mëse e domosdoshme që të ndahet shëndetësia nga mbrojtja sociale sepse ne s’e dimë kur mbaron pandemia, ne s’e dimë çfarë pandemie tjetër mund të na vijë, nuk dimë çfarë pasojash do na sjelli pandemia...në breza dhe shëndetësia duhet të fokusohet te shëndeti. Duhet të jetë një ministri më vete them unë për çështjet sociale... (Pjesëmarrësja 2, kandidatja për deputete e PS)
- ◆ Edhe pse brenda ministrisë së shëndetsisë dhe mirëqenies sociale ka drejtori dhe departamente që janë të angazhuara me problematika të caktuara, sërish ka krijuar amulli. Kjo pasi bëhet fjalë për 2 sisteme ku secili prej tyre përballet me sfida të mëdha, si sistemi shëndetsor dhe ai social. Unë personalisht do të thoja që ndarja e tyre do të ndihmonte dhe do të lehtësonte, zgjidhjen e problematikave të 2 sistemeve ... (Pjesëmarrësja 5, kandidate për deputete e PD)

Një nga kandidatet për deputete e PS përcjell një qasje tjetër nga kolegia e saj. Ky organizim, sipas saj, mund të qëndrojë në këmbë njësoj siç është nëse shumica e shërbimeve sociale ofrohen tashmë online përmes E-Albania.

- ◆ “Po t’i ketë shërbime automatike, ministria merr më shumë rolin e rregullatorit, sepse ndjekja është e menjëhershme nga sistemi që aktivizohet sapo individ vjen në jetë dhe identifikohet për shembull me aftësi ndryshe. Ndërsa tani ministria ka dhe rol rregullator dhe rol ndjekës dhe rol monitorues edhe rol studiues, apo propozues ligjesh. Ndaj them që ofrimi i shërbimeve elektronike e lehtëson ministrinë në ushtrimin e roleve të tjera. Ama i duhet patjetër të ketë brenda saj të përfshirë një zyrë kërkimi”(Pjesëmarrësja 4, kandidatja për deputete e PS).

VI. TIPOLOGJIA E PROGRAMEVE

6.1 Të përbashkëtat dhe dallimet

Platformat elektorale që ndryshe njihen si programe përfaqësojnë instrumente komunikimi të rëndësishme që partia ka me votuesit. Detajimi i premtimeve i ndihmon studiuesit që të analizojë shkallën e përmbushjes së tyre (Mansergh and Thomson 2007)¹³ Por partitë racionale kanë arsye më të mira për të bërë premtime që i dinë se mund të mos jenë në gjendje t'i mbajnë, pasi janë pikërisht këto premtime me shanse të vogla për t'u përmbushur që shërbejnë për të krijuar hapsira negocimi për koalicionin qeverisës të së nesërme. Premtime të tilla “të pamundura” janë edhe ato që nxisin më shumë përkushtim tek mbështetësit kryesorë, por tërheqin edhe të ashtuquajturin “elektorat gri”.¹⁴ Në këtë garë elektorale opozita, e përfaqësuar nga “PD dhe Aleanca për ndryshim”, nisën të prezantonin premtimet e tyre për elektoratin shumë më herët sesa PS në pushtet, e cila zgjodhi fillimisht të tregonte punët e kryera gjatë 2 mandateve qeverisëse. Me përjashtim të LSI, asnjë nga 3 subjektet e tjera politike në garë nuk kanë publikuar programin në formatin e broshurave apo fletpalosjeve, duke u kufizuar vetëm në prezantimin me gojë të premtimeve përpara elektoratit. Megjithëse askush nuk priret të lexojë një program disafaqesh, botimi i premtimeve i shërben mediave dhe opinionit publik që të kuptojë diferencën midis subjekteve politike në garë dhe mbi bazën e veçorive dalluese më të spiktarua të orientojë qyetarët për të votuar. Kërkesës së drejtuar 4 subjekteve politike për të na vënë në dispozicion platformën e tyre elektorale të shkruara iu përgjigjën vetëm PS dhe LSI.

Partia Socialiste ka një Plan Kombëtar Veprimi dhe jo një program të mirëfilltë në garën zgjedhore të 25 Prillit ku përcakton sikurse bën me dije kryetari i saj Edi Rama, “një vizion për Shqipërinë 2030, i mbështetur nga veprime konkrete të matshme dhe të prekshme...”¹⁵ Në këtë plan veprimi përcaktohet, jo vetëm çfarë PS synon të bëjë vit pas viti, por edhe çfarë nuk do të bëjë, dukë vënë theksin se nuk ka ndërmend të ndryshojë disa shtylla kryesore të qeverisjes sikurse politikatat fiskale. Prezantimi në

13. <https://ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC4695960/>

14. The Fulfillment of Parties' Election Pledges: A Comparative Study on the Impact of Power Sharing https://homepage.univie.ac.at/laurenz.ennser/pledges_web.pdf

15. Fjalimi i Edi Ramës në 8 Mars 2021 - Prezantimi i Planit të Veprimi

publik i këtij plani ka nisur tashmë, por ende nuk është bërë publik ajo pjesë e planit që i referohet specifikisht çështjes së personave me aftësi të kufizuara. Broshura me planin e veprimit për këtë kategori sociale u siguroa gjatë intervistave me kandidatët dhe kandidatet për deputet të kësaj force politike.

LSI ka një broshurë prej 20 faqesh, 10 nga të cilat janë premtime dhe 10 ilustrime. Në të nuk përmenden konkretisht “Personat me Aftësi të Kufizuara”

Në dallim nga aleati i saj, PD, nuk ka publikuar një broshurë apo një fletëpalosje të programit të saj, por pikat e platformës i ka të artikuluara në fjalimet e kryetarit Lulzim Basha. Në një prej tyre, gjatë prezantimit të programit për Mirëqenien Sociale, kreu i PD i referohej Personave me Aftësi të Kufizuara konkretisht me premtimin për *“dyfishimin e menjëhershëm të asistencës ekonomike dhe që njerëzit me aftësi ndryshe të jenë pjesë e vendimmarrjes reale të qeverisë”*.¹⁶ Detaje të tjera nga ky program specifik për Personat me Aftësi të Kufizuara janë dhënë intervistat me kandidatët dhe kandidatet për deputetë të kësaj force politike, mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe qasja krahasimore me subjektet e tjera politike në garë. Prej tyre veçohet si një ndër premtimet e para që priten të përmbushen në 6 muajt e parë të qeverisjes demokrate, rishikimi i KDPAK.

- ◆ “Më imediate që ata e kanë kërkuar është rishikimi i shqipërimin të konventës së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, pasi duke u përkthyer në mënyrë jo të mirë dhe të saktë, janë shkelur të drejtat e tyre. Kjo është një nga pikat që mendojmë të realizojmë së pari, pastaj për të tjerat do të përcaktohet në vijim.” (Pjesëmarrësja 5, kandidate për deputete e PD)

Nisma Thurje në dallim nga tri subjektet e mësipërme nuk ka një program qeverisës, por ligjvënës. Synimi i saj është të hyjë në parlament dhe të çojë përpara 33 projektligje për të rritur shanset e një përfaqsimi sa më të drejtë dhe gjithëpërfshirës të popullit në parlament.¹⁷ NTH ka bërë publike në 31 Mars në faqen zyrtare të saj në Facebook Nisma#Thurje, një video prej 51 minutash, në të cilën për afro 1 min e 30 sekonda, shpjegon nismat ligjore për PAK. Më konkretisht, “pr/ligj për aksesin e Personave me Aftësi të Kufizuara në të gjitha entet publike dhe pr/ligjin dhe dhënia e lehtësirave fiskale çdo punëdhënësi i cili do të punësojë Personat me Aftësi të Kufizuara”. Këto dy projektligje në fakt rezultojnë të jenë miratuar përkatësisht: aksesueshmëria e Personave me Aftësi të kufizuara garantohet prej Ligjit Nr. 93/2014 dhe punësimi i tyre, prej ligjit Nr.15/2019. Për këto dy çështje nuk janë ligjet që mungojnë, por fryma për zbatimin e tyre.

16. Fjalimi i Lulzim Bashës në 8 shkurt 2021-Prezantimi i programit për Mirëqenien Sociale

17. Intervistë e Endrit Shabanit në studion e ABC News 22 shkurt 2021

Tabela 2. Krahasimi midis programeve të dy partive (PS-LSI)

	Qasja e PS për Personat me Aftësi të Kufizuara	Qasja e LSI për Personat me Aftësi të Kufizuara
Sa herë përmendet	Për këtë kategori një plan veprimi të posaçëm. Kjo referuar planit të veprimit të vënë në dispozicion për studimin nga PS.	Personat me Aftësi të Kufizuara përmenden 2 herë tek programi për Arsimin dhe Punësimin. Kjo referuar të dhënave të përftuara nga intervista me kandidatët. Në programin e botuar kjo kategori sociale nuk ishte përmendur
Çështje të përbashkëta të trajtuara në program	Krijimi i Fondit Social të Punësimin të dedikuar për aftësinë e kufizuar, i cili shërben për të siguruar nxitjen e punësimin të personave me aftësi të kufizuara. Ky fond përdoret vetëm për financimin e projekteve që synojnë punësimin; vetëpunësimin...	Për çdo biznes, i cili punëson të rinj 18-29 vjeçare në punën e tyre të parë ose që kanë më shumë se 6 muaj si të papunë, do subvencionohet me 2000 Euro/vit që do të shërbejë për sigurime shëndetsore, sigurime shoqërore dhe trajnim për punën që ata do të kryejnë. Kjo do të ndahet në %, psh për Personat me Aftësi të Kufizuara, për nënat kryefamiljare, për zonat e pazhvilluara, shifra do të jetë më e lartë se 2000 euro që të nxiten punësimi i kategorive të disavantazhuara.
Elementë Sasiorë që ofrohen për zgjidhje	Rritje me 80% e numrit të përfutuesve të KEMP në 2025 Ngritja e 3 qendrave të reja zhvillimore në 2023. Ngritja e 2 qendrave të reja rehabilituese të shëndetit mendor në 2022	Mungojnë objektiva sasiorë që përcaktojnë numrin apo përqindjen e përfutuesve konkrete të Personave me Aftësi të Kufizuara nga premtimet e artikuluar në program.
Elementë cilësorë që ofrohen për zgjidhje	Bashkitë të marrin masa për krijimin e hartës së nevojave për tipologjinë e shërbimeve sociale që duhet të marrin Personat me Aftësi të Kufizuara. Ngritja e shërbimeve për mbështetjen e jetesës së pavarur të Personave me Aftësi të Kufizuara Intelektuale, mbi 25 vjeç, që janë aktualisht në spitalet psikiatrike Organizimi i sesioneve informuese për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara për prezantimin e paketës së shërbimeve shëndetësore që ofrohen nga institucionet publike	Hartëzim të nevojave për ndërhyrje në infrastrukturën e të gjithë sistemit arsimor duke filluar nga parashkollori e deri në universitet, ku tejet e rëndësishme është dhe krijimi i kushteve për Personat me Aftësi të Kufizuara. Plotësimi i nevojave për më shumë mësues ndihmës të specializuar për fushat përkatëse sepse komuniteti i tyre është i madh dhe me nevoja specifike Krijimi i lehtësirave që Personat me Aftësi të Kufizuara të kenë më shumë mundësi për të vijuar studimet e larta në universitet, duke përfshirë trajtimin me bursa

Tabela 3. Krahasimi midis programeve të dy partive (e majta e PS - e djathta e PD)

	Qasja e PS për Personat me Aftësi të Kufizuara	↔	Qasja e PD për Personat me Aftësi të Kufizuara
Sa herë përmendet	Për këtë kategori një plan veprimi të posaçëm. Kjo referuar planit të veprimit të vënë në dispozicion për studimin nga PS.		Partia Demokratike ka prezantuar publikisht Programin për Mirëqenien Sociale ku Personat me Aftësi të Kufizuara përmendet vetëm 1 herë. Kandidatet e saj për deputet pohojnë se kanë edhe një miniprogram të dedikuar për këtë kategori sociale.
Çështje të përbashkëta të trajtuara në program	Forcimi i bashkëpunimit institucional ndërmjet strukturave qendrore dhe pushtetit vendor dhe ndërveprimi me OPAK në të gjitha nivelet.		Bashkëpunimi me të gjitha institucionet përgjegjëse për hartimin e politikave konkrete për fuqizimin dhe rritjen e përfshirjes së Personave me Aftësi të Kufizuara dhe për marrjen e çdo mase për shmangien e diskriminimit.
Elementë Sasiorë që ofrohen për zgjidhje	Rritje me 80% e numrit të përfituesve të KEMP në 2025 Ngritja e 3 qendrave të reja zhvillimore në 2023. Ngritja e 2 qendrave të reja rehabilituese të shëndetit mendor në 2022		Dyfishimi të menjëhershëm të asistencës ekonomike edhe për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara.
Elementë cilësorë që ofrohen për zgjidhje	Bashkitë të marrin masa për krijimin e hartës së nevojave për tipologjinë e shërbimeve sociale që duhet të marrin Personat me Aftësi të Kufizuara. Ngritja e shërbimeve për mbështetjen e jetesës së pavarur të Personave me Aftësi të Kufizuara Intelektuale, mbi 25 vjeç, që janë aktualisht në spitalet psikiatrike Organizimi i sesioneve informuese për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara për prezantimin e paketës së shërbimeve shëndetësore që ofrohen nga institucionet publike		Të promovojmë mbrojtjen dhe angazhimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, me qëllim që, të jenë të përfshirë në institucionet publike dhe ato të medias. Zhvillimi i një reforme të thellë në fushën e arsimimit me qëllim përfshirjen e kësaj kategorie në sistemin publik arsimor Të mbështes zhvillimin e një reforme në fushën e formimit profesional dhe nxitjen për punësim të tyre. Shteti të krijojë një lloj hapsire dhe mundësie, në bashkëpunim me sektorin privat Të rishikojë përkthimin e KDPAK

Tabela 4. Krahasimi mes programeve të dy dy partive LSI-NTH

	Qasja e LSI për Personat me Aftësi të Kufizuara	Qasja e NTH për Personat me Aftësi të Kufizuara
Sa herë përmendet	Përmendet 2 herë tek programi për Arsimin dhe Punësimi. Kjo referuar të dhënave të përfuara nga intervista me kandidatët. Në programin e botuar kjo kategori sociale nuk ishte përmendur	Nisma Thurje ka një program ligjvënës, të cilin ende nuk e ka publikuar. Referuar të dhënave të përfuara nga intervista me kandidatin për deputet, nga 33 projektligje, 3 prej tyre i referohen PAK. Megjithëse për NTH, PAK nuk shihet si grupim më vete por si pjesë e kategorive sociale të disavantazuara
Çështje të përbashkëta të trajtuara në program	Mbështetje direkte për kompanitë që punësojnë të rinj 18-29 vjeçare në punën e tyre të parë ose që kanë më shumë se 6 muaj të regjistruar si të papunë, do subvencionohet me një masë prej 2000 Euro/vit. Ka një pikëzim për këto çështje...për zona të caktuara të vendit ku papunësia spikat më shumë ky shkallzim me pikë vjen më i lartë	Sistemi i pikëzimit është të kombinuarit të nevojës me mundësinë. Pra do të duhet të vendosësh kritere. Renditja bëhet në bazë të pikëve. P.SH. Je person me aftësi të kufizuar 10 pikë, je i ve/e ve, je me ndihmë ekonomike, je jetim. Pra aty ku është më e madhe nevoja por edhe vështirësia për ta bërë vetë.
Elementë Sasiorë që ofrohen për zgjidhje	Mungojnë objektiva sasiorë që përcaktojnë numrin apo përqindjen e përfutuesve konkrete të Personave me Aftësi të Kufizuara nga premtimet e artikuluara në program.	Ndihma ekonomike për familjet në nevojë, ku ndër të tjera përfshihet dhe Personat me Aftësi të Kufizuara të jetë e barabartë me minimumin jetik.
Elementë cilësorë që ofrohen për zgjidhje	Hartëzim të nevojave për ndërhyrje në infrastrukturën e të gjithë sistemit arsimor duke filluar nga parashkollori e deri në universitet, ku tejet e rëndësishme është dhe krijimi i kushteve për Personat me Aftësi të Kufizuara. Plotësimi i nevojave për më shumë mësues ndihmës të specializuar për fushat përkatëse sepse komuniteti i tyre është i madh dhe me nevoja specifike Krijimi i lehtësirave që Personat me Aftësi të Kufizuara të kenë më shumë mundësi për të vijuar studimet e larta në universitet, duke përfshirë trajtimin me bursa	Tek strehimi kemi propozuar që Personat me Aftësi të Kufizuar të ketë përparësi, përmes reformimit të të gjithë sistemit Duhet stimuluar krijimi i skemave sociale që garanton se shtresat në nevojë përfitojnë nga përdorimi ekonomik i hapsirës publike të qyteteve

6.2 Premtime të mbështetura në studime dhe konsultime

Studime të Instituteve Kërkimore, konsulta me shoqatat që kujdesen për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe modele të importuara nga jashtë janë burimet prej nga partitë politike kanë mbështetur premtimet e tyre për komunitetin e Aftësisë së Kufizuar në Shqipëri. PS, duke qenë në kërkim të mandatit të tretë, është mbështetur në planin e saj të veprimit, kryesisht vetëm tek studimet e MSHMS si dhe studimet që kanë bërë vetë shoqatat për të sjellë zërin e grupeve të interesit në tryezat vendimmarrjes politike.

- ◆ “Kryesisht jemi bazuar te studimet e ministrisë dhe te studimet që kanë këto shoqatat sepse ato janë më të sakta në kuptimin që sjellin dhe zërin grupi i punës i ka përdorur të gjitha këto”(Pjesëmarrësja 2, kandidatë për deputetë e PS)
- ◆ Në strategji është e përcaktuar që vendimet nuk duhet të merren pa ata. Unë besoj që po, janë konsultuar për planin e veprimit, sepse personi përgjegjës në Ministrinë e Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale (P.I.), është shumë procedurale dhe nuk mund të anashkalonte hartimin e programit pa zhvilluar konsultimet e tyre sikurse e do rregulli. Por sa janë reflektuar opinionet dhe mendimet e tyre në këtë program, këtë nuk di të ta them. (Pjesëmarrësja 4, kandidatë për deputetë e PS)

Por sa është dëgjuar zëri i këtij komuniteti në hartimin e planit të veprimit të PS? Por sa është dëgjuar zëri i PAK në hartimin e planit të veprimit të PS? Për t’iu për t’iu përgjigjur kësaj pyetje, kandidatja për deputetë e Partisë Socialiste i referohet raportit të monitorim-vlerësimit në vitin 2018-të, të dokumentit strategjik 2016-2020 i cili është kryer nga qeveria:

- ◆ Gjetjet kryesore janë të raportit të monitorimit janë: Përqaftimi i modelit psiko-social të Aftësisë së Kufizuar, sipas standarteve të OBSH, nevoja për të reformuar dhe krijuar shërbime të integruara në nivel qendror dhe lokal si dhe hartimi i një baze ligjore të re për përdorimin e fondit social. Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuara mbi 25 vjeç mungojnë ndaj rekomandohet që të nis të ofrohen për grupmoshën mbi 25 vjeç. Nevojitet të ngrihen shtëpitë për Personat me Aftësi të Kufizuara të shëndetit mendor dhe depistimi tek fëmijët e porsalindur për problemet e dëgjimit. Kjo e fundit është kryer. Tek paketat falas të Ministrisë së Shëndetsisë është vendosur tashmë implanti koklear falas pikërisht për ata që kanë probleme dëgjimi. Gjithashtu, referuar raportit të monitorimit, nevojiten përcaktime specifike në kodin zgjedhor për të përfshirë Personat me Aftësi të Kufizuara në vendimmarrje. Kjo nuk është reflektuar. Kërkohet edhe më shumë përpjekje në promovimin e artistëve dhe sportistëve me Aftësi të Kufizuara si

modele që sensibilizojnë dhe shoqërinë. Edhe kjo mungon por mund të thuhet se janë shënuar përparime në drejtim të ofrimit të një plani individual mësimor për çdo nxënës me aftësi të kufizuara. Gjatë këtyre 4 viteve është rritur numri i mësuesve ndihmës në shkolla. Ndërkaq ende nuk janë bërë plane për përfshirje të Personave me Aftësi të Kufizuara përtej arsimit bazë, e cila rekomandohet edhe në dokumentin strategjik që përmenda më sipër... (Pjesëmarrësja 4, kandidate për deputete e PS)

Kandidatet për deputete të PD konfirmojnë, gjatë intervistave se në bazë të miniprogramit për Personat me Aftësi të Kufizuara, se në bazë të programit të tyre elektoral qëndrojnë konsultimet me vetë grupet e interesit, por nuk përjashtojnë edhe njehsimin e objektivave specifike me programet e partive simotra në BE

- ◆ “Absolutisht që të gjitha këto pika, janë konsultuar me grupet e interesit, me OPAK, por janë edhe të njehsuara me programet e partive simotra. Sigurisht që ajo çka kërkohet nga Personat me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri është zbatuar edhe në programet e partive simotra. Është përvojë e njohur e bazuar në atë çka kanë realizuar edhe në vende të tjera të Evropës.” (Pjesëmarrësja 5, kandidate për deputete e PD)
- ◆ “Kanë qenë problematika që PD i ka identifikuar duke u takuar me target grupet në fjalë, që janë ngritur direkt prej tyre. Me këtë dua të them sidomos për gjera konkrete këtu, të prekshme sikurse është rritja e aksesueshmërisë së PAK në institucione.” (Pjesëmarrësja nr.7, kandidate për deputete e PD)

Më shumë e orientuar kah modeleve të importuara duket LSI, kandidatet për deputet të së cilës tregojnë edhe vendet e origjinës ku janë vënë më parë në zbatim dy projektet e propozuara, konkretisht ajo e subvencionimit të biznesit për të nxitur punësimin e kategorive të disavantazhuara dhe projekti i “Fermës Pedagogjike”

- ◆ “Modeli i subvencionimit për të stimuluar punësimin e të rinjve është një model që neve e kemi marrë nga partia jonë simotër portugeze me të cilët ne kemi diskutuar, mënyrën sesi ata e kanë hartuar të gjithë programin, si e kanë zbatuar, pasi ata kanë filluar zbatimin që në vitin 2014.” (Pjesëmarrësja 6, kandidate për deputete e LSI)
- ◆ “Pothuaj iu kemi referuar të gjithë programeve, jo vetëm politike, por i kemi referuar programeve të modeleve më të mira europiane pse jo dhe amerikane. Modelin e “Shkollës Pedagogjike” e kemi marrë pikërisht nga modele e shkolles norvegjeze apo finlandeze, ku që aty lidhet dashuria për tokën.” (Pjesëmarrëse 3, kandidatja e LSI)

Jashtë vëmëndjes së LSI, në hartimin e programit, veçanërisht të atij për arsimin, nuk janë lënë edhe rekomandimet e bëra nga *“partnerët tanë ndërkombëtarë, ku kandidatet për deputet veçojnë testimin e PISA, UNICEF, Banka Botërore, OSBE.”* Ndryshe shfaqet në qasjen e tij subjekti politik Nisma Thurje. Edhe pse kjo forcë e re ngjason me lëvizje si Podemos në Spanjë, apo 5 Yjet në Itali, kur flitet për program, drejtuesit e saj politik janë të qartë në vizionin që kanë:

- ◆ “Jo nuk kemi marrë programet e askujt sepse nuk mendojmë se është kjo zgjidhja. Pra nuk është importimi i zgjidhjeve nga jashtë të problemeve që nuk janë tonat. Çdo shtet ka përgjigjet e veta specifike. Ne kemi disa shqetësime politike, për të cilat absolutisht duhet një zgjidhje. Mënyra si veprojmë ne në këto raste është që bashkëpunojmë me Think Tanks, të cilat bëjnë studimet përkatëse dhe ofrojnë përgjigjet teknike të pyetjeve politike që ne kemi. Por pyetjet janë politike? Ne nisemi nga idea si t’i krijojmë shanse të barabarta për të gjithë.” (Pjesëmarrësi 1, kandidati për deputet i NTH)

Sa i takon parashikimit në programin politik të nevojës për të ndjekur çështjen e Personave me Aftësi të Kufizuara me studime në vazhdim me qëllim identifikimin e problemeve ekonomike, sociale, juridike dhe politike të këtij komuniteti, të vetmet forca politike që kanë planifikuar diçka të tillë janë PS dhe LSI. E para sepse ia kërkon dokumenti strategjik mbi Personat me Aftësi të Kufizuara. Një nga kandidatet për deputete sqaron se *“miratimi i strategjisë së re nga qeveria i hap automatikisht rrugën dy studimeve monitoruese, të cilat do të verifikojnë pas 2 vitesh nevojën për përditësim dhe rishikim të strategjisë.”* Sa i takon LSI, kjo forcë politike synon të realizojë me të ardhur në pushtet një studim mbarëkombëtar për të përcaktuar minimumin jetik.

- ◆ “Si forcë politike për herë të parë do vendosim në momentin që do vimë në pushtet atë që quhet “Niveli i Minimumit jetik të Jetesës”. Ende në 2021 qeveria nuk ka nxjerrë nivelin e minimumit jetik. Duke mos nxjerrë minimumin e nivelit jetik nuk mund të bësh dot politika sa vende do të hapen, sa vende do të mbyllen, aq më pak të planifikosh objektiva realë për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.” (Pjesëmarrësja 3, kandidate për deputete e LSI)

Kur flitet për plane dhe studime një zë të posaçëm duhet të zënë edhe kostot financiare. Në planin e veprimit të PS, e vetmja forcë politike që ka një faturë të përllogaritur financiare për kostot që kanë objektivat për PAK, përllogaritet që *“kostot indikative të jenë në vlerën e 1 miliardë e 200 milionë lekë. Nga këto buxheti i shtetit është rreth gjysma, 528 milionë lekë, ndërsa donatorët janë 110 milionë. Ka një hendek financiar, që është rreth 555 milionë ... Idea është që ato do të luftojnë për ta arritur të ngrenë fondet për këtë gjë. Mund të jetë UNICEF apo BB e shumë organizata të tjera. Pra hendeku është më pak se 50%, gati 43%.”* (Pjesëmarrësja 4, kandidata për deputete e PS)

VII. PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË AXHENDËN E FUSHATËS

“Nuk kemi takime të dedikuara për Personat me Aftësi të Kufizuara. Ne nuk i shohim si një grup. I shohim si pjesë e shumë kategorive sociale në Shqipëri që janë të disavantazuara.” Ky këndvështrim i një prej drejtuesve politik të Nismës Thurje, forca e re që garon në këto zgjedhje për të sjellë më shumë shanse të barabarta dhe për të kontribuar në një demokraci më përfaqësuese dëshmon një qasje përgjithëse ndaj Personave me Aftësi të Kufizuara. Edhe në prezantimin e platformës ligjvënëse kjo forcë e re politike, bëri publike si dy projektligje të dedikuara për këtë komunitet, aksesin në entet publike dhe nxitjen e punësimit përmes lehtësirave fiskale për bizneset, duke dëshmuar mungesë e informacionit sa i takon kuadrit ligjor ekzistues për Personat me Aftësi të Kufizuara. Diçka e tillë nuk mund të kalojë pa u vënë re. Sidomos kur drejtuesë politik të NTH pohojnë se nuk kanë planifikuar takime elektorale të posaçme me këtë kategori, edhe pse në listat e saj për kandidatë dhe candidate për deputetë ka vendosur përfaqësues të këtij komuniteti. Zgjedhja për të mos planifikuar takime me Personat me Aftësi të Kufizuara gjatë fushatës argumentohet ndryshe nga PS. Kandidatet e saj për deputetë të intervistuar për raportin kanë përdorur togfjalëshin *“ekspozim”* dhe *“zgjedhje për të mos u kërkuar votën”* kësaj kategorie në përgjigjet si më poshtë:

- ◆ “Për fushatë nuk i kam në plan me thënë të drejtën se nuk dua t’i ekspozoj, nuk para preferoj të bëj fushatë me ata”. (Intervista 2, pjesëmarrëse kandidatja për deputete e PS)
- ◆ “Shkoj të paktën 2 herë në vit, tek një qendër që kujdeset për Personat me Aftësi të Kufizuara, për t’i parë edhe nëse kanë nevojë për t’i ndihmuar me ndonjë financim apo ndonjë person që mund t’i punësojë pasi përfundojnë kurset profesionale. Por unë nuk ia kam kërkuar ndonjëherë votën.” (Intervista 4, Pjesëmarrëse kandidatja për deputete e PS)

Edhe pse duket si qasje e politikanëve të përgjegjshëm, të cilët nuk duan të përdorin për qëllime elektorale komunitete vulnerabël sikurse PAK, sërish ky përjashtim i Personave me Aftësi të Kufizuara gjatë fushatës të krijon perceptimin e një forme shpërfillje të kamufluar pas humanizmit. Veçanërisht nëse këto përgjigjie i kryqëzojmë me skepticizmin që ndihet tek raporti i këtij komuniteti me politikën. Një nga kandidatet

për deputet e LSI tregon se nuk janë të rralla rastet kur në takimet elektorale që zgjedh të zhvillojë me njerëz të këtij komuniteti, dëgjon t'i thuhet *“për periudhë fushatash të gjithë vini dhe na dëgjoni çështja është çfarë ndodh me ne mbas zgjedhjeve?”*


- ◆ *“...Kuptohet që secili prej tyre do të donte të shikonte përfaqësuesine tij të drejtpërdrejtë, një zë të drejtpërdrejt në organet drejtuese jo vetëm brenda partive, por edhe në këshilla bashkiak, apo në parlament...Megjithatë ajo që do të thoja është që me kalimin e viteve gjithmonë e më shumë ky komunitet ka qenë në qendër të vëmendjes së politikës prandaj nuk duhet të tregohemi nihilist se është rritur ndërgjegjsimi është rritur vëmendja është ulur diskriminimi dhe janë rritur përpjekjet për ta përfshirë Personat me Aftësi të Kufizuara në jetën e përditshme. Por është e vërtetë që ka një dallim nga zonat e zhvilluara në zonat më pak të zhvilluara, nga zonat urbane në zonat rurale.”* (Pjesëmarrësja 6, kandidatë për deputete e LSI)

Personat me Aftësi të Kufizuara do të jenë pjesë e axhendës elektorale për PD. Kandidatja për deputete e kësaj force politike e cilësoi *“takimin me këtë komunitet, si një nga pikat më të rëndësishme të axhendës së saj, për më tepër kur i është dhënë dhe një zë i posaçëm në program shqetësimeve të tyre.”* Megjithëse marrëdhënia e kandidatit për deputet me këtë komunitet është krejtësisht personale dhe jo domosdoshmërisht lidhet me aktivizimin e tij në parlament, sërish duhet pohuar se dalja e opozitës nga kuvendi dy vite më parë, i ka shkëputur disi deputetët demokratë nga terreni. Kjo reflektohet mes rreshtash në përgjigjien më poshtë:

- ◆ *“Në qytetin ku unë jam deputete ka edhe një qendër të trajtimit të personave me aftësi ndryshe. Mbjaj mend që në vitin 2017-të, unë i kam vizituar. Kam shpenzuar një ditë të tërë me këta fëmijë, të cilit ishin të jashtëzakonshëm dhe më kanë mbetur në mendje. Madje vitin e ri të 2018-ës kam zgjedhur të bëjë urimin tim për miqtë e mi me kartolinat e vizatuara nga këta fëmijë. Duke qenë se kemi lënë mandatet nuk jame e informuar për zhvillimet e fundit sa i takon këtij komuniteti, por do ta kem në vëmendjen time dhe si pjesë të programit gjatë fushatës elektorale. Do bëj patjetër edhe takim me këtë target grup.”*

VIII. KONKLUZIONE

Tabela 5. Diagrama logjike e temave



9.1 Analiza e të dhënave cilësore.

Nga të dhënat e gjeneruara prej intervistave të transkriptuara dhe të analizuara është arritur të ndërtohet diagrama logjike e mësipërme, në të cilën paraqiten temat kryesore të evidentuara nga përgjigjet e përfaqësuesve politik të partive pjesëmarrëse në këtë hulumtim. Korrelacionet mes koncepteve janë burimet prej nga rrjedhin edhe gjetjet kryesore. Nevoja për të përmirësuar aksesueshmërinë në shërbime publike dhe jopublike, mbështetja e Personave me Aftësi të Kufizuara me bursa sociale për studimet e larta, si dhe nxitja e mëtejshme e punësimit të kësaj kategorie janë tre fushat në të cilat janë fokusuar premtimet e 4 subjekteve politike të marrë në studim. Nevoja për më shumë mbështetje në arsimim e kanalizuar kryesisht tek mundësimi i kushteve për të vijuar studimet e larta, është një aspekt kyç për të shmangur edhe peshën e paragjykimimit që Personat me Aftësi të Kufizuara e ndjejnë kur tentojnë të përfshihen në vendimmarrjen publike. Kjo ndihet edhe në vlerësimin me ngjyresa përgjithësisht kritike që përfaqësuesit politikë adresuan ndaj angazhimit të Personave me Aftësi të Kufizuara në organe ekzekutive. Vlerësimi i kontributit të tyre si “i zbehtë” nga përfaqësues politik, kryesisht të krahut opozitar, ndikon në një lloj ndroje të atyre kandidatëve për deputet që janë me aftësi të kufizuara, por që refuzojnë të vetë-identifikohen si pjesë e këtij komuniteti. Edhe pse janë potencialisht fitues në këtë garë zgjedhore për shkak të pozicionimit të mirë në renditje dhe ndryshimeve të kodit zgjedhor që mundëson një hapje të pjesshme të listave, këta kandidatë nuk do të jenë me gjasë “avokatët” mbrojtës të të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara.


Duke pasur barrën e të qenurit “ndryshe” por thajse aspak të përfaqësuar, Personat me Aftësi të Kufizuara shfaqen skeptik ndaj politikës, ndërsa vetë politikanët zgjedhin të mos e vlerësojnë si elektorat të mirëfilltë të cilit i kërkojnë votën gjatë fushatës. Megjithëse është ende herët të përcaktohet niveli i pjesëmarrjes së Personave me Aftësi të Kufizuara në axhendën e takimeve elektorale sa kohë që ka ende fushatë përpara, në intervistat me kandidatët dhe kandidatet për deputet duket se propozimet për këtë kategori, do të jenë kryesisht të tërthorta dhe jo specifike për këtë kategori. Kjo zgjedhje për të trajtuar Personat me Aftësi të Kufizuara si pjesë të grupeve të disavantazuara, ndërsa partitë pohojnë se kanë kryer konsultimet me shoqatat që mbrojnë të drejtat e kësaj kategorie, ngrenë pikëpyetje se sa vërtet janë adresuar me zgjidhje, shqetësimet e Personave me Aftësi të Kufizuara në programet e partive. Me objektiva kryesisht të patmatshëm, të vetmet aspekte specifike të identifikuar në programet e partive, janë modelet e ndërtruara mbi bazën e sistemit të pikëzimit. Kjo skemë e ngritur aktualisht për vlerësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara në marrjen e KEMP-it, sugjerohet të përdoret edhe për nxitjen e punësimit. Konkretisht LSI ka marrë modelin portugez të nxitjes së punësimit për kategoritë e disavantazuar,

përmes subvencionimit të biznesit dhe NTH ka marrë modelin grek të shfrytëzimit të hapësirave publike (i referohet kioskave në kryqytet) nga Personat me Aftësi të Kufizuara dhe kategori të tjera në nevojë, si mënyrë punësimi. Mes konstatimeve për shqetësimet kryesore që ky komunitet ka, kandidatët dhe kandidatet për deputet të 4 subjekteve politike të marrë në analizë vlerësojnë si të domosdoshme:

- ◆ Rritjen e aksesit për Personat me Aftësi të Kufizuara në mjedise publike dhe jopublike transport, informacion dhe komunikim.
- ◆ Zbatimin e kuadrit ligjor ekzistues për Personat me Aftësi të Kufizuara.
- ◆ Ndërmarrja e nismave ligjore të reja në frymën e KDPAK.
- ◆ Shqipërimi i saktë i konventës KDPAK.

Për të gjitha këto objektiva të përcaktuar si prioritete gjatë intervistave me kandidatët dhe kandidatet për deputetë të PS, PD, LSI, që kanë një plan/program qeverisës, nevojitet që të krijohet një ministri më vete për çështjet sociale, ku të adresohen të gjitha politikat që lidhen me zgjidhjen e problemeve sociale të kategorive të disavantazhuara, mes tyre dhe Personat me Aftësi të Kufizuara. Nga kjo analizë e të dhënave janë identifikuar 5 probleme prioritare që lidhen edhe me përfundimet e këtij raporti.

Tabela 6. Piramida e Problemeve



Ekzistojnë ligjet për Personat me Aftësi të Kufizuara, por ata mbeten të disavantazuar. Edhe pse PS në pushtet e vetme prej 4 vitesh thotë që 80% e ligjeve për AK janë miratuar, ky komunitet mbetet dukshëm i disavantazuar për shkak të një lloji "ftohtësie" të administratës ligjzbatuese ndaj këtij komuniteti, por edhe mungesës së informacionit të duhur nga Personat me Aftësi të Kufizuara.

Kandidatët potencialisht fitues me Aftësi të Kufizuara në këto zgjedhje nuk vetë-pranohen se i përkasin kësaj kategorie sociale dhe aq më pak të ngrënë zërin për problemet e Personave me Aftësi të Kufizuara. Sfidat me mendësinë është edhe brenda këtij komuniteti.

Përshtatja e nevojshme në infrastrukture dhe transport është një detyrim ligjor, por sërish Personat me Aftësi të Kufizuara iu premtohet akses. Partitë kryesore pohojnë se do të angazhohen në një zbatim më të mire të ligjit, në programet e tyre mungojnë objektiva të detajuar sesi do të arrihet kjo gjë.

Në shumicën e objektivave të programeve partiake, Personat me Aftësi të Kufizuara nuk identifikohet më vetë por si pjesë e kategorive të disavantazuara.

Aktivizimi politik duhet t'i faktorizonte Personat me Aftësi të Kufizuara, por kjo nuk ka ndodhur. Ky komunitet nuk ka një zë identifikues brenda partive.

9.2 Përfundimet e raportit kërkimor

- ◆ Partitë kryesore politike në garë për zgjedhjet parlamentare të 25 Prill-it nuk kanë bërë ende publike programin e plotë, ndërkohë që kanë mbetur pak kohë nga fushata elektorale. Në ato aspekte të programit që janë bërë publike në media, rezultojnë të ketë hapsira të vogla të dedikuara drejtpërdrejtë për Personat me Aftësi të Kufizuara, ose në disa raste premtohen nisma ligjore për këtë kategori që janë miratuar tashmë.
- ◆ Sa i takon çështjeve që shqetësojnë Personat me Aftësi të Kufizuara, kandidatët dhe kandidatet për deputet pohojnë se platforma elektorale është përqëndruar tek përmirësimi i ligjzbatimit, rritja e aksesueshmërisë në shërbime publike dhe jopublike, mbështetje me bursa sociale për Personat me Aftësi të Kufizuara për të vijuar studimet universitare dhe nxitjen e punësimit. Programeve u mungojnë objektiva të matshëm për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe përlogaritje të kostove për zbatimin e tyre. Edhe në rastin e vetëm kur këto kosto janë përlogaritur, rezultojnë të ketë një hendek financiar prej afro 50%, nga plotësimi i të cilit varet zbatimi i platformës elektorale për këtë kategori.
- ◆ Kandidatët dhe kandidatet për deputet shfaqën kryesisht tendencën për t'iu referuar Personave me Aftësi të Kufizuara jo si një komunitet më vete, por si pjesë e një kategorie të gjerë grupimesh të disavantazuara.
- ◆ Në programet elektorale nuk përmendet asnjë plan konkret për vaksinimin e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe ca më pak për menaxhimin e pasojave që COVID-19 mund të ketë lënë në shëndetin e njerëzve si pjesë të këtij komuniteti, që konsiderohet sipas OBSH-së mes atyre kategorive që janë të riskuara.
- ◆ Jo të gjithë kandidatët dhe kandidatet për deputetë kanë vendosur të bëjnë takime elektorale me Personat me Aftësi të Kufizuara. Ata/ato pohojnë se nuk e shohin këtë kategori si një elektorat i cili mund të ekspozohet duke iu kërkuar publikisht vota.
- ◆ Në listat e kandidatëve për deputetë ka të përfshirë edhe Persona me Aftësi të Kufizuara, madje në disa raste ato janë të pozicionuar në të ashtuquajturat renditje fituese, por këta individë nuk vetë-pranohen se janë pjesë e këtij komuniteti, duke dëshmuar se zëri i Personave me Aftësi të Kufizuara në foltoren e parlamentit, me gjasë, do të vijojë të mungojë.

IX. REKOMANDIME

- ◆ Partitë kryesore do të duhet të mos vonojnë më shpалosjen e plotë të platformës së tyre elektorale, për t'ju dhënë kohë elektoratit të Personave me Aftësi të Kufizuara që të informohet dhe të kuptojë veçoritë e premtimeve të çdo force politike.
- ◆ Premtimet do të duhet të artikuloohen sa më qartë dhe me objektiva specifike të matshëm për Personat me Aftësi të Kufizuara. Për të kuptuar nëse ato janë të realizueshme do të duhet të ketë shifra dhe objektiva me të dhëna konkrete, të shoqëruara me afate kohore se kur do të përmbushet secili. Përlllogaritja e kostove do të duhet të publikohet gjithashtu si element i pandarë i një platforme të qenësishme elektorale.
- ◆ Kandidatët dhe kandidatet për deputet do të duhet t'i referohen Personave me Aftësi të Kufizuara për atë çfarë përfaqësojnë, një komunitet më vete, me një variacion kufizimesh, ku secila prej tyre kërkon një adresim të posaçëm dhe të barabartë.
- ◆ Pavarësisht ndjeshmërisë që implikon kjo kategori vulnerabël edhe ndaj steriotipeve, takimet me Personat me Aftësi të Kufizuara nuk mund të shmangen ose të përcaktohen nga vullneti dhe këndvështrimi individual i kandidatit. Ato duhet të jenë në axhendën elektorale të takimeve për kandidatët e çdo partie, duke u kujdesur për formën e publikimit dhe respektimit të protokollit antiCovid.
- ◆ Personat me Aftësi të Kufizuara do të duhet të zgjojnë sensin e përkatësisë brenda komunitetit për të luftuar mendësinë paragjyquese që është një tjetër pengesë që ndihet edhe në marrëdhënie mes njëri-tjetri. Në mënyrë që kjo mendësi të mos shëndrrohet në një tjetër barrierë që t'i kufizojë atyre përfaqësimin në parlament për të advokuar në vetë të parë shqetësimet që kanë.
- ◆ Në listat e partive duhet të ketë më shumë kandidatë dhe kandidate për deputetë që vijnë nga rradhët e komunitetit të Aftësisë së Kufizuar

Referencat

CDC, People with Disabilities, <https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/need-extra-precautions/people-with-disabilities.html> 16 Mars 2021

Vendim i KQZ <http://kqz.gov.al/2021/03/02/zaz-nr-40-caktohet-si-njesia-administrative-ku-do-te-zbatohet-projekti-pilot-per-votimin-dhe-numerimin-elektronik/>, 2.03.2021

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Ligji 10019 dt.28.12.2008, i rishikuar në 2012,2015 dhe 2020 <http://cec.org.al/wp-content/uploads/2017/06/KODI-ZGJEDHOR-2015-Teksti.pdf>

Deklarata e Parimeve / Preambul, Statuti i Partisë Socialiste, 29 Shkurt 2020

“Qëllimet Politike”/pika 2, Statuti i Partisë Demokratike, 28 Prill 2018

Parimet Kryesore, pika 6.1., Statuti i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Tetor 2012

“A Compilation of Political Party Statues”, NDI, fq. 39, v.2011

Analizë e angazhimit politik në Shqipëri, IDM, 2016 <https://ndi.org/sites/default/files/IDM%20Audit%20of%20Political%20Engagement%20%28Shqip%29.pdf>

Norris, P., A Virtuous Circle: Political Communications in Post-Industrial Societies, fq. 9 New York: Cambridge University Press , 09.04.2000

“Agro Challenge, Start-Up në prezantimin final”, <https://adriapol.al/wp-content/uploads/2020/09/STARTUP-ET-N%C3%8B-PREZANTIMIN-FINAL-agro-challenge.pdf> Gusht 2020

European Union Agency for Fundamental Rights – Are people with disabilities elected to national parliament? - <https://fra.europa.eu/en/publication/2014/indicators-right-political-participation-people-disabilities/national-mps>

Coalition Policy-Making under Constraints, <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC4695960/> , 4 Maj 2014

The Fulfillment of Parties’ Election Pledges: A Comparative Study on the Impact of Power Sharing https://homepage.univie.ac.at/laurenz.ennser/pledges_web.pdf

Fjalimi i Edi Ramës, Prezantimi i Planit të Veprimit, 8 Mars 2021

Fjalimi i Lulzim Bashës, Prezantimi i programit për Mirëqenien Sociale, 8 shkurt 2021

Intervista e Endrit Shabanit në studion e ABC News, 22 shkurt 2021

Raporti i Monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit të Personave me Aftësi të Kufizuar,
<https://platforma-pak.al/wp-content/uploads/2019/06/Raport-Monitorimi-PKVPK.pdf>
2016-2020

Diagrama Logjike e përshtatur nga një ese mbi “Kuptimi i Sistemit Kompleks të Gjeoshkencës”, Carleton College, https://serc.carleton.edu/earthandmind/posts/logic_diagrams.html Prill 2010

Tipologjia krahasimore e programeve e përshtatur nga “Capitalism Strikes Back: Why and What Consequences for Social Sciences?”, <https://journals.openedition.org/regulation/2142> , Qershor 2007